



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi sipas denoncimit të regjistruar me numër 12-9701/1 të datës 26.12.2022 , me pretendime kundër personave të punësuar në ----- dhe-----
----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me LPKKI nuk ka elemente për veprim kompetent. Denoncimi të dorëzohet për veprim kompetent në PTHP Shkup.

Lënda me numër 12-9701/1 të datës 26.12.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Nga ana e Ministrisë së drejtësisë më datë 26.12.2022 , për veprim kompetent në KSHPK është dorëzuar denoncimi nga një gazetar ----- dhe është formuar lënda me numër 12-9701/1 të datës 26.12.2022.

Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për të njëjtën gjendje faktike, në kërkesë janë bashkuar lëndët 12-9677 nga 22.12.2022 dhe 12-113/1 nga 01.09.2023.

Në denoncim, parashtruesi deklaroi se ka marrë një mesazh me email nga z. -----
-----, Drejtor i Përgjithshëm i Telekomit Gjerman, fillimisht drejtuar më 28 dhjetor 2006 disa drejtorëve të -----, ndër të cilët ishte edhe kryeministri aktual i Maqedonisë, të gjithë drejtorët e atëhershëm të ----- në Maqedoni dhe

anëtarët e atëhershëm të këshillit drejtues të ----- . Thuhet se mesazhi përmban një rrëfim personal të z. ----- për korrupsion të lartë, që të gjithë në mesazh janë të përfshirë në procesin e monopolizimit, vërtetim se ----- është në pronësi të -----, si dhe pretendime specifike për ryshfet. Denoncimi kërkon përgjigje se përse e gjithë grupi ministror hesht së bashku me kryeministrin dhe kërkohen edhe dorëheqjet për shkak të këtij skandali korruptiv.

Duke marrë parasysh pretendimet nga denoncimi, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe raporti duhet të dorëzohet për veprim kompetent në Prokurorinë Themelore Publike Shkup.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: B.K.Sh

Miratoi: K.N anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar
Biljana Ivanovska